



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 105, datë 05.07.2019

PËR

**MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË KANDIDATËVE QË KANË PLOTËSUAR
KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, PËR
KËSHILLTARË DHE NDIHMËS LIGJORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e tij nr. 17, nr. 18 dhe nr. 19, datë 29.01.2019, si dhe në propozimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriteve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë lidhur me kandidatët që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë 9 (nëntë) mujore Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për Këshilltarë Ligjorë, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për Ndihmës Ligjorë, sipas Lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

LIDHJA 1

LISTA E KANDIDATËVE QË KANË PLOTËSUAR KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, PËR KËSHILLTARË LIGJORË

1. Edlira Shpëtim Llango;
2. Metush Arif Meçka;
3. Evriklejda Thimi Semani;
4. Gerti Trifon Shani.

LIDHJA 2

LISTA E KANDIDATËVE QË KANË PLOTËSUAR KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, PËR NDIHMËS LIGJORË

1. Gersiana Dashamir Skifteri;
2. Irena Vangjel Zhurka;
3. Blerta Paqësor Hamzallari;
4. Enkelejda Dilaver Patrioti;
5. Sokol Sabri Loci;
6. Esida Gëzim Bruçi;
7. Eglantina Gani Shabanaj;
8. Elsa Mustafa Gjeli;
9. Nertila Xhevair Kalanxhi.